



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHETËRËTOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:**

Komuna e Shtipit

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (630)

**Qëllimi i revizionit:** Nëse raportet financiare janë të liruara nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet, informacionet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me rregullativën ligjore relevante.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- kontrole të pa vendosura dhe mos harmonizim i bazave të tatim paguesve të cilët ndikojnë në arkëtimin e plotë e të ardhurave;
- arkëtimi jo i plotë i tatimeve, taksave dhe kompensimeve,
- miratime të lëshuara për ndryshimin e investitorit në rastet kur ekziston një marrëveshje në fuqi për tjetërsimin e tokës ndërtimore të pa ndërtuar që nuk është përmbushur;
- mos harmonizim ndërmjet evidencës tatimore dhe të kontabilitetit të kërkesave,
- shumë e konsiderueshme e kërkesave të vjetruara për të cilat nuk janë ndërmarrë aktivitete për arkëtime ndërsa për një pjesë të të hyrave të realizuara nuk janë evidentuar kërkesat.

### Mendimi i dhënë \*:



Mendim të pavolitshëm në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore.

### Rekomandimet kyçe:

- vendosja e kontroleve dhe harmonizim i vazhdueshëm i bazave të tatim paguesve
- llogaritjen dhe arkëtimin e të gjitha tatimeve, taksave dhe kompensimeve
- lëshimi i paralajmërimeve për arkëtimin, llogaritjen dhe kërkesave të papaguara të interesit
- vendosjen e mekanizmave për respektimin e dispozitave të kontratave të lidhura nga blerësit e tokës ndërtimore.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

Dobësi në Ligjin për taksat komunale te numrat tariforë 9 dhe 10 taksa komunale për shfrytëzimin e rrugëve dhe rrugicave dhe mirëmbajtjes së ndriçimit publik. Dobësi në Ligjin për tatimet mbi pronë për harmonizimin e gjendjes së regjistrit të patundshmërive të komunave me regjistrin që e udhëheq AKP e RMV-së.

**Vërejtjet e marra të draft-raportit:** Nuk janë marrë vërejtje për draft-raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 26-121/9 nga 07.09.2022.

\*



pozitive



me rezervë



të pavolitshëm



të përmbajtur